



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 738 Akti

Nr. 770 Vendimi  
Tiranë, më 31.5.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Olsi Komici</b>	Kryesues
<b>Suela Zhegu</b>	Relatore
<b>Brunilda Bekteshi</b>	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova, në datën 31.5.2024, ora 11:30, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Aida Mërtiri**, me detyrë ndihmëse ligjore pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Pika 5 e nenit 179/ b të Kushtetutës, pika 1 e nenit Ç dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Aida Mërtiri, me detyrë ndihmëse ligjore pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, në bazë të pikës 4 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 15.6.2021, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.
2. Trupi gjykues i shortuar për të shqyrtuar çështjen përbëhet nga komisionerët Suela Zhegu me cilësinë e relatores, Olsi Komici kryesues dhe Brunilda Bekteshi anëtare. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 25.6.2021 u caktua me mirëkuptim kryesues i trupit gjykues komisioneri Olsi Komici. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatorja e çështjes. Subjekti i rivlerësimit u njoh me anëtarët e trupit gjykues dhe deklaroi mospasjen e konfliktit të interesit me komisionerët. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar znj. Elka Ermenkova.
3. Procesi i rivlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV “Vlerësimi i pasurisë” të ligjit nr. 84/2016 dhe, veçanërisht me nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin, deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.
4. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet, si: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).
5. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar<sup>1</sup>, duke konkluduar se:
  - *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
  - *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
  - *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
  - *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
  - *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*
6. AKSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016,

<sup>1</sup> Raporti i dërguar nga ILDKPKI-ja me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 8.1.2018.

si dhe ka dërguar një raport të arsyetuar<sup>2</sup>, duke konkluduar mbi përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Aida Mërtiri.

7. KLGJ-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, pesë dokumentet e tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar<sup>3</sup> mbi subjektin e rivlerësimit.
8. Në vijim, relatorja e çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.
9. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatores së çështjes në datën 21.5.2024, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit Aida Mërtiri dhe njoftimin e saj për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 – 47, të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe duke i kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.
10. Për një proces të rregullt ligjor, znj. Aida Mërtiri i janë garantuar të drejtat: (i) për t'u njoftuar për fillimin e procedurës së rivlerësimit; (ii) për t'u njohur me përbërjen e trupit gjykues; (iii) për përfundimin e hetimit administrativ kryesisht, duke i kaluar barrën e provës/shpjegimet mbi rezultatet e hetimit. Subjektit iu dha koha e nevojshme për t'u njohur me dosjen dhe për të disponuar kopje të saj.
11. Znj. Aida Mërtiri, pasi u njoh me rezultatet e hetimit, ka paraqitur shpjegimet dhe provat e saj në datën 27.5.2024. Subjekti i rivlerësimit lidhur me rezultatet e hetimit deklaroi se është dakord me gjetjet e konstatuara për hetimin e kryer nga Komisioni. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi ta ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

12. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancë dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht në datën 27.5.2024.
13. Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 31.5.2024, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në ambientet e Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova.
14. Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit dhe u mbrojti personalisht, si dhe shprehu opinionin e saj në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer. Në përfundim, subjekti i

---

<sup>2</sup> Raporti mbi kontrollin e figurës për subjektin nr. \*\*\*, datë 6.9.2023, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 30.8.2023, të KDZH-së.

<sup>3</sup> Raporti profesional me nr. \*\*\* prot., datë 9.5.2023.

rivlerësimit pranoi rezultatet e hetimit të kryera nga Komisioni dhe kërkoi konfirmimin në detyrë.

### **III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

**15.** Subjekti i rivlerësimit Aida Mërtiri ka qenë bashkëpunuese gjatë procesit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ, si dhe ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni. Znj. Aida Mërtiri ka qenë korrekte dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

### **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI**

**16.** Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

**17.** Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

**18.** Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

**19.** Ndërsa, sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, AKSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

**20.** Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, ka rezultuar se Komisioni në kryerjen e funksionit të tij kushtetues realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

**21.** Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a. provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
- b. raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c. deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara ndër vite nga subjekti në ILDKPKI;
- d. provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private;
- e. raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga AKSIK-ja;

- f. raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja;
  - g. deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
  - h. shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituara nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.
22. Bazuar në nenin 179/b, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Aida Mërtiri, me detyrë ndihmëse ligjore pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, u krye mbi bazën e tri kritereve: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; vlerësimi i aftësive profesionale.

### A. VLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI

23. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, kreu një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, i cili konsistoi në verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit të kësaj pasurie, të ardhurat, shpenzimet, si dhe mundësinë për fshehje të pasurisë dhe deklarim të rremë apo konflikt interesi.
24. Ky hetim është përqëndruar mbi të gjitha në pasuritë e deklaruara nga znj. Aida Mërtiri në deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2, e dorëzuar në ILDKPKI më 23.1.2017, ku subjekti i rivlerësimit Aida Mërtiri nuk ka deklaruar pasuri të paluajtshme në pronësi të saj.

24.1 Në deklaratën *Vetting*, subjekti nuk ka deklaruar pasuri në posedim. Në formularin e deklaratës së pasurisë, sipas shtojcës nr. 2, në seksionin ku subjektet e rivlerësimit duhet të deklarojnë adresën e plotë ku janë të regjistruar në gjendjen civile, subjekti ka deklaruar adresën: “*Bashkia Tiranë, Njësia Administrative Nr. \*, Rr e B, p. \*\*\**”.

24.2 Në lidhje me këtë adresë, në përgjigjet e pyetësorit standard<sup>4</sup> subjekti ka shpjeguar: “*Unë kam banuar dhe banoj në këtë adresë: Rr e B, pallati \*\*\*, shk. \*, ap. \* (sot me ndryshimet e reja është bërë: Njësia Administrative Nr. \*, Rr e B, nd. \*\*, ap. \*). Unë jetoj së bashku me nënën time në shtëpinë e saj (bashkëlidhur dokumentacioni sqarues)*”.

24.3 Subjekti, në përgjigje të pyetësorit standard, ka depozituar dokumentacion provues<sup>5</sup>, sipas të cilit rezulton se nëna e saj, znj. M.M, nëpërmjet kontratës së dhurimit nr. \*\*\* rep., nr. \*\* kol., datë 22.1.1999, ka përfituar si dhuratë nga prindërit 2/4 e një apartamenti në Tiranë, me sip. 108 m<sup>2</sup>. Referuar kartelës së pasurisë të depozituar nga subjekti, ky apartament rezulton në bashkëpronësi të znj. M.M dhe dy motrave të saj.

<sup>4</sup> Ardhur me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 23.09.2021

<sup>5</sup> Aktet bashkëlidhur:

- certifikatë familjare Aida Mërtiri, datë 14.9.2021.
- vërtetim lëshuar nga Njësia Administrative Nr. \*, datë 13.7.2021.
- certifikatë familjare M.M, datë 13.7.2021.
- vërtetim lëshuar nga Njësia Administrative nr. \*, datë 13.7.2021.
- kontratë dhurimi nr. \*\*\* rep., nr. \*\* kol., datë 22.1.1999.
- vërtetim pronësie lëshuar nga Hipoteka Tiranë, datë 22.12.1999.
- certifikatë regjistrimi pronësie lëshuar nga ASHK-ja, datë 19.5.2021.
- kartela e pasurisë së paluajtshme datë 19.5.2021.
- kartela e pasurisë së paluajtshme dhe harta treguese.
- vendim për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. \*\* rep., nr. \*\* kol., datë 19.1.2021.
- certifikatë familjare nr. \*\*\* e përbërjes familjare Gj.Gj.
- librezë e pagimit të ujit lëshuar nga UK sh.a., Qyteti Tiranë.
- librezë e pagimit të dritave lëshuar nga CEZ Shpërndarje sh. a.
- librezë e pagimit të telefonit për pajtimtar M.M.

24.4 Në vijim, referuar vërtetimeve lëshuar nga Njësia Administrative Nr. \*, datë 13.7.2021, ka rezultuar se shtetaset M.M dhe Aida Mërtiri banojnë në të njëjtën adresë dhe janë banorë të Njesisë Administrative Nr. \*, me adresën Rr e B, nr. \*\*, hyrja \*, ap. \*.

24.5 Referuar librezave të furnizimit me ujë të pijshëm dhe energji elektrike, rezulton se për apartamentin e ndodhur në Rr e B, titullar i kontratave me këta operatorë furnizues është shtetasja M.M.

### **Hetimi i Komisionit**

24.6 ASHK – Drejtoria Vendore Tiranë Veri<sup>6</sup> ka informuar se në emër të znj. Aida Mërtiri rezulton e regjistruar pasuria e llojit apartament me sip. 106 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*, në adresën Rr e B, p. \*\*, shk. \*, ap. \*, Tiranë, në bashkëpronësi me 3 persona të tjerë, me datë regjistrimi 11.5.2023.

24.7 Në lidhje me faktin se subjekti rezultoi bashkëpronarë në pasurinë ku banon ka shpjeguar<sup>7</sup> se: *“Mamaja ime M.M ka vendosur që pjesën takuese 11/20 pjesë të pandarë të kësaj pasurie, e konvertuar me 58.3 m<sup>2</sup>, të ma dhurojë mua, me kontratë dhurimi nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 13.4.2023. Kështu, unë me regjistrimin e kësaj kontrate në ASHK, jam bërë pronarë e 11/20 pjesë e pandarë e pasurisë objekt i kontratës së dhurimit.*

*Ndërkohë edhe tezja ime S.Ll ka shfaqur dëshirën e saj për dhurimin e pjesës 1/20 të pandarë të pasurisë/bashkëpronare e pasurisë “apartament”, nga e cila ka në pronësi 1/20 pjesë të pandarë të kësaj pasurie, sipas kontratës së dhurimit nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 27.4.2023.*

*ASHK-ja, me marrjen e këtyre kontratave të dhurimit të cituara si më sipër, ka bërë bashkimin e pasurisë në një të vetme dhe tashmë unë, Aida Mërtiri, jam bashkëpronarë në pjesën 12/20 të pandarë të pasurisë/bashkëpronare e pasurisë “apartament”, ndodhur në zonën kadastrale \*\*\*, me nr. pasurie \*\*\*, ndodhur në Tiranë me sipërfaqe totale 106 m<sup>2</sup>”.*

24.8 Për të provuar deklaratimet e saj, subjekti ka depozituar aktet vijuese:

- Çertifikatën familjare, ku rezultojnë se shtetaset S.Gj/Ll dhe nëna e subjektit janë motra;
- Kontratë dhurimi nr. \*\*\* rep., nr. \*\* kol., datë 21.1.1999;
- Dëshmia e trashëgimisë ligjore nr. \*\* rep., nr. \*\* kol., datë 19.1.2021;
- Kontratë dhurimi nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 13.4.2023;
- Kontratë dhurimi nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 27.4.2023;
- Çertifikatë regjistrimi pronësie datë 11.5.2023.

24.9 UKT-ja<sup>8</sup> ka informuar se në emër të shtetasës M.M (nëna e subjektit) rezulton kontrata nr. \*\*\*, për objektin me adresë në Rr e B, me nr. pasurie \*\*\*, me status aktiv në kategorinë e konsumatorëve familjarë.

24.10 UKT-ja<sup>9</sup> ka informuar se në emër të subjektit Aida Mërtiri dhe vajzave të saj E dhe A.K nuk rezulton ndonjë kontratë e lidhur për shërbim ujësjellës-kanalizime Tiranë.

<sup>6</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.6.2023.

<sup>7</sup> Në përgjigjet e pyetësorit ardhur me *emailin* e datës 30.4.2024.

<sup>8</sup> Me shkresën nr. k-\*\*\* prot., datë 14.7.2023.

<sup>9</sup> Me shkresën nr. k-\*\*\* prot., datë 14.7.2023.

24.11 FSHU-ja<sup>10</sup> ka informuar se në emër të subjektit Aida Mërtiri dhe vajzave të saj E dhe A.K nuk rezultojnë të dhëna në sistemin e tyre, si dhe nuk rezulton të kenë kontrata furnizimi me energji elektrike.

24.12 Në emër të shtetasës M.M (nëna e subjektit), referuar të dhënave të sistemit të faturimit, rezulton një abonent me kontratë furnizimi në instancën e Tiranës me adresë Rr e B, në kabinën *materniteti i vjetër*.

24.13 ISSH-ja<sup>11</sup> ka referuar të ardhurat e përfituara për:

- shtetasen Aida Mërtiri nga punësimi i saj pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për periudhën janar 2013 – qershor 2015, si dhe pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë deri në prill 2023;
- shtetasen E.K (e bija e subjektit) për të ardhura të përfituara nga punësimi i saj për periudhën nëntor 2022 – prill 2023;
- shtetasen M.M, e cila ka përfituar pension pleqërie nga nëntori 1993 e në vijim në masën 24.126 lekë.

24.14 Nga hetimi i kryer nga Komisioni ka rezultuar se:

- ✓ Subjekti në vitin 2023 ka përfituar 12/20 pjesë të apartamentit ne Tiranë, me sip. 106m<sup>2</sup>, banesë ku banon aktualisht, nëpërmjet dhurimit të bërë nga nëna dhe tezja e saj, në përputhje me ligjin.

## 25. Në lidhje me adresa të tjera banimi të subjektit të rivlerësimit

25.1 Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile/Ministria e Brendshme<sup>12</sup> ka informuar se referuar regjistrin kombëtar të gjendjes civile, shtetasja Aida Mërtiri me vajzat dhe ish-bashkëshortin kanë qenë të regjistruar pranë Njesisë Administrative Nr. \* dhe janë larguar nga kjo njësi administrative për t'u regjistruar në Njësine Administrative Nr. \*, në datën 30.10.2008.

25.2 Në lidhje me këtë adresë banimi subjekti ka shpjeguar se: *“Unë, subjekti i vlerësimit Aida Mërtiri, kam lidhur martesë faktike dhe ligjore më 26.5.1999. Për shkak se atë periudhë kam qenë shtatzënë dhe kam qenë me punë në Ministrinë e Mbrojtjes (vërtetim “Për vjetërsinë në punë për efekt pensioni”, nr. \*\*\* prot., datë 21.11.2019, lëshuar nga DRSSH Tiranë) bashkë me ish-bashkëshortin kemi jetuar në shtëpinë e mamasë sime (M.M), ndodhur në Tiranë, në adresën Rr e B, p. \*\*\*, shk. \*, ap. \*, Tiranë, banesë ku kam jetuar dhe jetoj aktualisht.*

*Pas lindjes së vajzës, ish-bashkëshorti kërkoi për një banesë në Tiranë. Kujtoj që për një periudhë të shkurtër kohore në vitin 2000 (pas korrikut) gjetëm një hyrje, ndodhur në rrugën “A.D”, pallati \*\*, shkalla \*, ap. \*, referuar shkresës nr. \*\*\* prot., datë 30.4.2024, të Njesisë Administrative Nr. \*, Bashkia Tiranë)]. Në atë kohë (me sa mbaj mend) nuk kemi formalizuar me shkrim kontratë qiraje, pasi pronare e shtëpisë ishte një grua (nuk e mbaj mend emrin), në moshë, e sëmurë, e cila i kërkonte paratë në dorë sepse blinte ilaçet dhe ne detyroheshin t'ia jepnin me faturë dore në fillim të çdo muaji. S'kaluan pak muaj (mbase 4 apo 5 muaj) dhe zonja na kërkoi të dilnim me urgjencë pasi ia kërkuan shtëpinë për t'ia blerë pasi do të kthehej në dyqan (siç ka ndodhur me të vërtetë, pasi të gjitha katet e para janë kthyer në*

<sup>10</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.5.2023.

<sup>11</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.5.2023.

<sup>12</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 25.5.2023.

*dyqane/njësi shërbimi) dhe, për shkak të kohës së shkurtër, fëmijës së vogël (disa muajshe), e vetmja zgjidhje ishte vendosja përsëri te mamaja ime (shtëpia e saj), ku edhe jetoj edhe aktualisht (Rr e B, p. \*\*\*, shk. \*, ap. \*, Tiranë).*

*Moslidhja e kontratës apo mosruajtja e dokumentit me shkrim dore që nënshkruhej çdo muaj prej ish-bashkëshortit dhe zonjës/pronare të shtëpisë ka ardhur pikërisht për faktin se ajo thoshte që “jam e sëmurë dhe blej ilaçet”.*

*Ndërkaq, mosruajtja e këtyre deklaratave për pagesën e këstit mujor (që realisht nuk e mbaj mend, por një vlerë e vogël se 1+1 kishim me qira, një dhomë ishte e mbyllur pasi pronarja kishte mobilet e saj), si dhe mosdisponimi i këtyre dokumenteve vjen edhe si rezultat i faktit se ka kaluar një kohë shumë e gjatë (24 vite) dhe mbështetur edhe në mospasje detyrimi ligjor për ruajtjen në kohë të këtyre dokumenteve, pasi unë asnjëherë nuk kam qenë në pozicion të tillë pune, për të cilën të kem pasur detyrim ligjor deklarimin e pasurisë”.*

## 26. DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

26.1 Subjekti në deklaratën *Vetting* ka deklaruar të ardhurat<sup>13</sup> si vijon:

<sup>13</sup> Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

- vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2016, nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Dega e Arkivit të Rajonit Tiranë;
- vërtetim mbi bazën e vlerësueshme dhe paga neto mesatare nr. \*\*\* prot., datë 25.11.2016, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Dega e Arkivit të Rajonit Tiranë, për periudhën janar – mars 1994, paga bruto 13.780 lekë (3 muaj x 13.780 lekë = 41.340 lekë);
- vërtetim mbi bazën e vlerësueshme dhe paga neto mesatare nr. \*\*\* prot., datë 31.10.2016, nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Dega e Arkivit të Rajonit Tiranë për periudhën prill – qershor 1994, paga mbi të cilën 9.650 lekë (3 muaj x 9.650 lekë = 28.950 lekë) dhe për periudhën korrik – dhjetor 1994, paga mbi të cilën 14.650 lekë (6 muaj x 14.650 lekë = 87.900 lekë);
- vërtetim mbi bazën e vlerësueshme dhe paga neto mesatare nr. \*\*\* prot., datë 27.10.2016, nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Dega e Arkivit të Rajonit Tiranë;  
për periudhën gusht – dhjetor 1997, paga neto (gjithsej 40.078 lekë);  
për periudhën janar – dhjetor 1998, paga neto (gjithsej 140.102 lekë);  
për periudhën janar – dhjetor 1999, paga neto (gjithsej 46.926 lekë);  
për periudhën janar – dhjetor 2000, paga neto (gjithsej 109.122 lekë);
- vërtetim mbi bazën e vlerësueshme dhe paga neto mesatare nr. \*\*\* prot., datë 27.10.2016, nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Dega e Arkivit të Rajonit Tiranë, për periudhën janar – nëntor 2001, paga neto (gjithsej 186.712 lekë);
- vërtetim mbi bazën e vlerësueshme dhe paga neto mesatare për periudhën 15.11.2001 – 28.8.2002, Reparti Ushtarak 2001, Plepa – Durrës, për periudhën nëntor – dhjetor 2001, paga neto (gjithsej 19.735 lekë) dhe për periudhën janar – maj 2002, paga neto (gjithsej 36.830 lekë);
- vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 8.11.2016, Drejtoria e Përgjithshme Ujësjellës-Kanalizime, emërim specialisti nr. \*\*\* prot., datë 15.5.2003 dhe tabela bashkëlidhur për pagesën neto të përfituar për periudhën maj – dhjetor 2003 (gjithsej 123.327 lekë);
- vërtetim mbi bazën e vlerësueshme dhe paga neto mesatare nr. \*\*\* prot., datë 31.10.2016, nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Dega e Arkivit të Rajonit Tiranë për periudhën shkurt – dhjetor 2004, paga (gjithsej 318.879 lekë), për periudhën janar – dhjetor 2005, paga (gjithsej 375.908 lekë), për periudhën janar – gusht 2006, paga (gjithsej 248.443 lekë);
- vërtetim për pagën bruto dhe neto, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për periudhën prill – dhjetor 2010 (gjithsej 382.391 lekë), për periudhën janar – dhjetor 2011, (gjithsej 560.880 lekë), për periudhën janar – dhjetor 2012 (gjithsej 601.829 lekë), për periudhën janar – dhjetor 2013 (gjithsej 595.208 lekë), për periudhën janar – dhjetor 2014 (gjithsej 628.031 lekë) dhe për periudhën janar – qershor 2015 (gjithsej 274.468 lekë);
- vërtetim nr. \*\* prot., datë 12.1.2017, lëshuar nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, për pagën neto për vitin 2015 (shuma 525.907 lekë) dhe për vitin 2016 (shuma 948.122 lekë), gjithsej 1.474.029 lekë;
- kërkesë datë 17.10.2016, drejtuar A.P, për të ardhurat e përfituara;
- kërkesë datë 17.10.2016, drejtuar AKBN-së, për të ardhurat e përfituara;
- kërkesë datë 27.10.2016, drejtuar Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, për të ardhurat e përfituara;
- kërkesë datë 17.10.2016, drejtuar \*\*-\* Group, për të ardhurat e përfituara;
- kërkesë datë 17.10.2016, drejtuar Ministrisë së Mbrojtjes për të ardhurat e përfituara;
- kërkesë datë 17.10.2016, drejtuar Drejtoria e Përgjithshme Ujësjellës-Kanalizimeve Tiranë, për të ardhurat e përfituara;
- kërkesë datë 17.10.2016, drejtuar Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për të ardhurat e përfituara;
- kërkesë datë 17.10.2016, drejtuar Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë për të ardhurat e përfituara;
- kërkesë datë 24.10.2016, drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore Tiranë për të ardhurat e përfituara;
- kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 7.11.2016, Ministria e Energjisë dhe Industrisë;
- kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 7.11.2016, nga AKBN-ja;



- Drejtoria e Përgjithshme e Naftës dhe Gazit, Patos (A) (1.10.1991 – 15.11.1993); nuk administrojnë bordero apo libër page për këtë subjekt (shkresa datë 2.11.2016 e ISSH-së); gjatë kësaj periudhe 16.2.1992 – 8.10.1992, specializim në Angli;
- Agjencia Kombëtare e Hidrokarbureve Tiranë (16.11.1993 – 28.3.1994) sipas vërtetimit të ISSH-së ekziston vetëm paga për periudhën janar – mars 1994, shuma 41.340 lekë;
- Shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. (sipas vërtetimit të lëshuar nga ISSH-ja, datë 31.10.2016, pasi shoqëria nuk ekziston), shuma 86.850 lekë;
- Ministria e Mbrojtjes, shuma 522.940 lekë;
- Reparti Ushtarak 2001, shuma 56.565 lekë;
- Drejtoria e Përgjithshme Ujësjetës-Kanalizime, shuma 123.327 lekë;
- Instituti i Studimeve e Projekteve Urbanistike (sipas vërtetimit të lëshuar nga ISSH-ja, datë 31.10.2017) shuma 943.225 lekë;
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, shuma 3.042.807 lekë;
- Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, në vazhdim, shuma 1.474.029 lekë.

### Hetimi i Komisionit

26.2 Union Bank<sup>14</sup> ka konfirmuar llogari rrjedhëse në emër të znj. Aida Mërtiri dhe gjendja në datën 23.1.2017 është 684.15 lekë.

26.3 Gjithashtu, Union Bank ka konfirmuar se znj. Aida Mërtiri ka llogari të përbashkët me shtetaset D dhe M.M. Gjendja në datën 23.1.2017 është 36.37 lekë.

26.4 Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka lidhur kontratë kredie hipotekore me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 20.9.2016, me kredidhënës Union Bank dhe kredimarrës D dhe Aida Mërtiri, të shumës 45.000 euro, me qëllim blerjen e një banese. Për këtë kredi është vënë kolateral një apartament me sip. 55./89 m<sup>2</sup>, me nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, ndodhur në rrugën “D.B”, godina \*\*, h. \*, ap. \*, Tiranë.

26.5 Nga verifikimi bankar nuk rezulton që subjekti të ketë paguar këste kredie nga llogaritë e saj bankare apo të ketë kryer derdhje në arkën e ndonjë banke.

26.6 Në përgjigje të pyetësorit standard për këtë kredi, subjekti ka shpjeguar se: *“Unë Aida Mërtiri sipas kontratës së kredisë hipotekore nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 20.9.2016, jam kredimarrëse ndaj Union Bank. Sqaroj se nuk kam deklaruar që kam kredi për të shlyer, për shkak se është një lapsus nga ana ime lidhur me konceptimin e kushteve të kontratave në momentin e nënshkrimit të tyre prej meje. Kështu, përgjatë gjithë këtyre viteve unë kam perceptuar se kam vepruar në cilësinë e dorëzaneses sipas kontratës së kredisë hipotekore me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 20.9.2016.*

*Kjo kontratë kredie është e lidhur me pasurinë nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, ndodhur në adresën rruga “D.B”, godina nr. \*\*, hyrja nr. \*, ap. nr. \*, shtëpi e blerë nga motra dhe e bllokuar si garanci pasurore në favor të Union Bank deri në shlyerjen e plotë të kredisë (për një periudhë prej*

---

- vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 12.10.2016 e Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë;

- kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 21.10.2016, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit;

- librezë pune;

- vendim për zgjidhje martesë nr. \*\*\* Akti, datë regji. 25.1.2016, nr. vendimi \*\*\*, datë 1.3.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë;

- nxjerrje llogarie datë 31.10.2016, e Raiffeisen Bank;

- nxjerrje llogarie datë 25.10.2016, e Credins Bank;

- nxjerrje llogarie page datë 20.1.2017, nga Union Bank, gjendja në datën 20.1.2017, në shumën 684.15 lekë;

<sup>14</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.5.2023.

25 vjet), duke u bazuar edhe në kontratën e shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 19.9.2016, mes shitësit (R.S) dhe blerësit (D.M).

Motra ime D.M është punësuar pranë Union Bank që prej datës 1.12.2007 dhe aktualisht mban pozicionin asistente menaxhimi në Drejtorinë e Përgjithshme Tiranë. Unë kam perceptuar se roli im ka qenë i “dorëzanëses”, pasi edhe qëllimi i lidhjes së kontratave të sipërcituara është blerja e këtij apartamenti në favor të D.M. Kjo kredi është disbursuar vetëm në favor të motrës sime, siç edhe rezulton nga informacioni nr. \*\*\* prot., datë 30.7.2021, vënë në dispozicion nga Union Bank”.

26.7 Nga hetimi i kryer nga Komisioni bazuar në aktet e depozituar nga Union Bank<sup>15</sup> ka rezultuar se motra e subjektit, znj. D.M, ka nënshkruar një kontratë shitblerjeje pasurie të paluajtshme me kusht kreditimi nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 19.9.2016.

26.8 Apartamenti i blerë me kredinë e disbursuar nga Union Bank është lënë si kolateral në favor të kësaj banke sipas kontratës së hipotekës nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 22.9.2016, ku hipotekues rezulton shtetasja D.M.

26.9 Referuar certifikatës për vërtetim pronësie nr. \*\*\*, datë 22.9.2016, në emër të shtetases D.M ka kaluar pasuria apartament me nr. \*\*\*, me sip. 55.89 m<sup>2</sup>, në adresën rruga “D.B”, Tiranë.

26.10 Në lidhje me detyrimet financiare të subjektit rezultoi se ajo nuk kishte deklaruar në deklaratën *Vetting* kredinë hipotekore, marrë pranë Union Bank në shumën 45.000 euro.

26.11 Në lidhje me këtë konstatim të Komisionit, subjektit iu kërkua të jepte shpjegime.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

26.12 Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e depozituara në datën 27.5.2024 ka dhënë të njëjtat shpjegime si gjatë hetimit nga Komisioni duke shpjeguar se kredia është marrë prej motrës së saj D.M, si punonjëse e Union Bank, me qëllim blerjen prej saj të një apartamenti banimi.

26.13 Ky apartament i blerë është bllokuar si garanci pasurore në favor të Union Bank deri në shlyerjen e plotë të saj, për një periudhë prej 25 vitesh, nëpërmjet kontratës hipotekore nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 22.1.2016, mes D.M dhe Union Bank.

26.14 Subjekti shprehet se: “Kjo kredi është disbursuar vetëm në favor të motrës, siç edhe rezulton nga informacioni me nr. \*\*\* prot., datë 30.7.2021, vënë në dispozicion nga Union Bank dhe këstet e kredisë janë likuiduar dhe po likuidohen vetëm prej saj. Nga leximi në tërësi i kontratës së kredisë nuk del në asnjë vend detyrimi im në pagimin e kësteve të kredisë, pra roli im si “kredimarrës” në këtë kredi ka qenë për elemente besueshmërie, politika të ndjekura nga vetë banka, e cila kërkonte garanci për kredinë, dhënë një punonjësi të saj, duke më bërë pjesë të kontratës së kredisë si person i besueshëm për faktin se isha në marrëdhënie pune (shtet), por edhe një nga njerëzit më të besuar të D.M (motra e saj).

Pra, gjatë gjithë kësaj periudhe, për shkak se detyrimi/këstet e kredisë përmbushet vetëm nga motra ime D.M në cilësinë e kreditorit, duke mos pasur detyrim për të shlyer këste kredie, sikurse me të drejtë ju keni konstatuar edhe nga verifikimi bankar, për shkak se unë, subjekti

<sup>15</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.5.2023.

*i rivlerësimit Aida Mërtiri, nuk kam paguar këste kredie, kam perceptuar se në këtë kredi unë nuk kam qenë në këtë rol, pra në rolin e kredimarrëses”.*

### **Vlerësimi i Komisionit**

26.15 Pas analizimit të shpjegimeve, Komisioni vëren se subjekti e ka pasur detyrim ligjor deklarimin e kredisë, pasi referuar kontratës së kredisë hipotekore nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 20.9.2016, subjekti dhe motra e saj rezultojnë kredimarrëse të shumës 45.000 euro, me qëllim blerjen e një banese, shtetaset D dhe Aida Mërtiri, me të drejta e detyrime të barabarta. Por, referuar akteve të depozituara nga Union Bank, rezulton se shuma është disbursuar në favor të shtetases D.M dhe kjo shumë është përdorur prej saj për blerjen e një apartamenti, në zonën D.B, si dhe këstet e kredisë janë paguar në vite prej saj. Këto fakte të dala gjatë hetimit, si dhe bazuar në shpjegimet e dhëna gjatë hetimit, rezulton se subjekti ka saktësuar pozitën faktike, në raport me kredinë e marrë në Union Bank, me qëllim blerjen e një apartamenti në favor të motrës.

26.16 Për sa më sipër, për Komisionin, mosdeklarimi si bashkëkredimarrëse e një kredie pranë Union Bank, mbetet një pasaktësi në deklarim, por përsa kohë nga hetimi ka rezultuar se nuk ka patur si qëllim fshehjen, kjo pasaktësi nuk mund të jetë mjaftueshëm për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

### **27. Hetimi i Komisionit për investime të subjektit dhe personave të lidhur**

27.1 Komisioni ka hetuar nëse subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të (2 vajzat në moshë madhore dhe ish-bashkëshorti S.K) kanë bërë investime në pasuri të paluajtshme apo të luajtshme. Nga hetimi nuk rezultuan që këta shtetas të kishin kryer investime apo të dispononin likuiditete.

27.2 DPSHTRR-ja<sup>16</sup> ka referuar se subjekti Aida Mërtiri dhe personat e lidhur nuk disponojnë automjet në pronësi të tyre.

27.3 QKB-ja<sup>17</sup> ka referuar se në emër të subjektit dhe personave të lidhur nuk rezulton ndonjë aktivitet tregtar i regjistruar.

27.4 Nga verifikimi i deklaratës *Vetting* të subjektit, rezultoi se shtetasi S.K, i cili deri në mars të vitit 2016 ka qenë ligjërish bashkëshorti i subjektit, nuk ka plotësuar deklaratën e pasurisë së personit të lidhur për pasuritë që disponon veçmas, referuar nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 dhe ligjit nr. 9049/2003.

27.5 Në lidhje me këtë konstatim të Komisionit, subjektit iu kërkua të jepte shpjegime.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

27.6 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar ndër të tjera se ajo dhe ish-bashkëshorti S.K i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për zgjidhjen e martesës me pëlqimin reciprok dhe miratimin e aktmarrëveshjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\* kol., datë 20.1.2016.

27.7 Subjekti ka shpjeguar se me ish-bashkëshortin kanë jetuar të ndarë që prej fillimit të vitit 2011 dhe, për pasojë, martesë humbi kuptimin e qëllimit të saj. Ish-bashkëshorti ka jetuar në shtëpinë e prindërve të tij në Gjirokastër, apartament, lagjia “P”, pallati \*, hyrja \*, ap. \*\*,

<sup>16</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.5.2023.

<sup>17</sup> Nr. \*\*\* prot., datë 17.5.2023.

kurse subjekti në shtëpinë e nënës M.M, trajtuar më sipër. Me zgjidhjen e martesës subjekti shpjegoi se nuk kanë bërë pjesëtim pasurie/kërkesëpadi në gjykatë, pasi nuk kishin në pronësi asnjë pasuri të vënë gjatë martesës.

27.8 Subjekti ka theksuar se ka qenë hera e parë e plotësimit të një deklaratë pasurie pasi gjatë karrierës së saj në punë të gjitha pozicionet (specialist në institucione të ndryshme shtetërore) që ka kryer nuk kanë pasur detyrim plotësimin e një deklaratë të tillë.

27.9 Subjekti ka shpjeguar se duke iu referuar deklaratës së pasurisë, e cila plotësohet nga subjekti i rivlerësimit që mbart detyrimin për deklaram të pasurisë së tij, bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es dhe të fëmijëve madhorë dhe çdo personi të përmendur në certifikatën familjare në bazë të ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për shkak të faktit se certifikata familjare e subjektit përmbante vetëm subjektin si kryefamiljar dhe dy fëmijët e saj dhe ka rezultuar se që prej vitit 2011 me ish-bashkëshortin nuk ka pasur asnjë lidhje, martesë faktike e, më pas, në datën 1.3.2016 edhe martesë juridike nuk ekzistonte, ka bërë plotësimin e deklaratës së pasurisë, pa e përfshirë ish-bashkëshortin në të.

27.10 Për këtë deklaram, subjekti ka shpjeguar gjithashtu se është bazuar edhe në faktin që prej vitit 2011 e në vazhdim, ish-bashkëshorti jo vetëm ka jetuar në Gjirokastrë në shtëpinë e prindërve të tij, por ka qenë në marrëdhënie pune në Gjirokastrë (nëntor 2015, i punësuar pranë subjektit tregtar “M” e në vazhdim<sup>18</sup>).

### **Vlerësimi i Komisionit**

27.11 Pas analizimit të shpjegimeve të subjektit dhe akteve provuese të depozituara prej saj, Komisioni vëren se mungesa e deklaratës së pasurisë së personit të lidhur/ish-bashkëshortit të subjektit është një pasaktësi nga ana e saj në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting*. Nga hetimi i kryer nga Komisioni nuk rezultoi që ky mosdeklaram ka pasur si qëllim fshehjen e ndonjë pasurie, apo investimi të kryer prej z. S.K.

27.12 Për pasojë, mosplotësimi i deklaratës së pasurisë nga ana e personit të lidhur/ish-bashkëshortit në deklaratën *Vetting*, mbetet një pasaktësi në deklaram, por nuk merr peshë për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

### **Konkluzion përfundimtar mbi pasurinë**

28. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave të kreut IV të ligjit nr. 84/2016, Komisioni krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit Aida Mërtiri ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë.

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

29. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikojë nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

---

<sup>18</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 22.7.2021, me lëndë kthim përgjigje të ISSH dhe shkresë nr. \*\*\* prot., datë 21.7.2021 me lëndë kthim përgjigje nga DRSSH Gjirokastrë.

30. AKSIK-ja ka dërguar raportin në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016<sup>19</sup> mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, ku ka konstatuar
- ✓ përshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit Aida Mërtiri në detyrën e ndihmësit ligjor.

### **Vlerësimi i Komisionit**

31. Komisioni ka kërkuar përditësim të raportit të dërguar nga AKSIK-ja të vitit 2017, për të cilin nuk janë disponuar informacione shtesë.

31.1 Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

31.2 Në përfundim të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, Komisionit i rezulton se subjekti i rivlerësimit Aida Mërtiri arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të nenit 59/1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, pasi nga verifikimet e kryera nuk rezultoi se ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ka dorëzuar në kohë deklaratën për figurën, si dhe nuk ka kryer deklaramë të pasakta ose nuk ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

### **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

32. Hetimi i Komisionit lidhur me këtë kriter është bazuar në analizimin e:

- raportit të hartuar nga KLGJ-ja<sup>20</sup> për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit;
- kriterëve të vlerësimit.

33. Vlerësimi profesional për subjektin e rivlerësimit Aida Mërtiri është kryer nga KLGJ-ja, i cili ka hartuar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, bazuar në:

- formularin e vetëdeklarimit, 3 dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe në të dhënat e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- 5 dokumentet ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- të dhënat nga burimet arkivore të KLGJ-së.

34. Në raport janë analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit:

- a. aftësive profesionale;
- b. aftësive organizative;
- c. etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale;
- d. aftësive personale dhe angazhimit profesional.

### **GJETJET NGA FORMULARI I VETËVLERËSIMIT DHE DOKUMENTET E PARAQITURA NGA SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT**

<sup>19</sup> Raporti mbi kontrollin e figurës për subjektin me nr. \*\*\*, datë 6.9.2023, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 30.8.2023, të KDZH-së.

<sup>20</sup> Nr. \*\*\* prot., datë 9.5.2023.

35. Nga 3 dokumentet e depozituara nga subjekti dhe 5 dosjet e vëzhguara të përzgjedhura me short, nuk u konstatuan problematika lidhur me vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit Aida Mërtiri, në cilësinë e ndihmësit ligjor.

### **TË DHËNA NGA BURIMET ARKIVORE TË KLGJ-SË**

36. Për subjektin e rivlerësimit Aida Mërtiri nuk ka të dhëna në burimet arkivore të KLGJ-së për periudhën e rivlerësimit, për shkak se ndihmësit ligjor ishin njësi e brendshme, e organizuar dhe vareshin nga gjykatat administrative. Për rrjedhojë, të dhënat profesionale dhe etike të tyre i disponojnë gjykatat përkatëse, ku ata kanë ushtruar detyrën si ndihmës ligjorë.

### **ANALIZA E GJETJEVE**

37. Analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tri grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti; (ii) 5 dokumenteve ligjore të vëzhguara, të përzgjedhura me short.

#### **1. Aftësitë profesionale**

##### *Njohuritë ligjore*

37.1 Procesi i rivlerësimit kalimtar të ndihmësve ligjorë pranë gjykatave administrative parashikohet dhe rregullohet nga neni 42, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe nga neni 165 i ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

37.2 Kështu, në nenin 42, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, parashikon se: “*Këshilltari Ligjor i Gjykatës Kushtetuese, ndihmësi ligjor i Gjykatës së Lartë, Gjykatës Administrative, si dhe ndihmësi ligjor në Prokurorinë e Përgjithshme, të cilët nuk janë magjistratë, vlerësohen bazuar në: a) relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura; dhe b) rezultatet e testimit pranë Shkollës së Magjistraturës*”.

37.3 Referuar parashikimeve ligjore e nënligjore në fuqi për kohën kur kryhet ky proces, vlerësimi profesional për ndihmësit ligjorë, ndryshe nga magjistratët-gjyqtarë, nuk ka pasur të miratuar nga një organ kompetent një Sistem Vlerësimi Profesional.

37.4 Për rrjedhojë, për ndihmësit ligjorë në gjykatat administrative nuk ka kriteret matëse të punës, sikurse ato kanë ekzistuar për magjistratët-gjyqtarë, prandaj vlerësimi i aftësive profesionale të tyre nuk ndjek detyrimisht të njëjtat rregulla, sikurse për magjistratët-gjyqtarë.

37.5 Në këto kushte, vlerësimi i aftësive profesionale të ndihmësve ligjorë pranë gjykatave administrative është kryer në përputhje me parashikimin e nenit 42, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 të sipërcituar, si dhe bazuar në përmbajtjen e nenit 6, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar më vonë.

37.6 Lidhur me subjektin e rivlerësimit Aida Mërtiri, për zotërimin prej saj të njohurive ligjore rezulton se ka një eksperiencë të pasur në njohjen e ligjit, bazuar në detyrat që ajo ka kryer dhe që u cituan më lart. Veçanërisht, eksperiencia e saj si sekretare gjyqësore në gjykatën më të rëndësishme të vendit i ka dhënë asaj njohuri në të drejtën administrative, por edhe në atë civile. Kjo eksperiencë e pasur e ndihmon atë të kryejë me profesionalizmin e duhur detyrën e ndihmësit ligjor në Gjykatën Administrative të Apelit.

37.7 Ndhmësi ligjor është njësi ndihmëse, pjesë e organizimit të brendshëm të gjykatave administrative. Në nenin 6, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative përcaktohet se: “Gjyqtari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit Administrativ, në veprimtarinë e tij ndihmohet nga ndihmësi ligjor”.

37.8 Në nenin 6, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, detajohen detyrat e ndihmësit ligjor, ku shprehimisht thuhet: “Ndhmësi ligjor ndihmon dhe këshillon gjyqtarin lidhur me përgatitjen e çështjes për gjykim dhe shqyrtimin gjyqësor, si dhe përgatit projekt-akte procedurale të nevojshme për gjykimin. Me kërkesë të gjyqtarit, ndihmësi ligjor bën kërtime ligjore dhe përgatit opinione me shkrim për problematika ligjore të karakterit procedural dhe material që lidhen me çështjet në gjykim”.

### **Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit Aida Mërtiri, bazuar nga aktet e vëzhguara**

37.9 Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit Aida Mërtiri në aktet e hartuara prej saj manifeston njohuritë e duhura ligjore për të prezantuar saktë çështjen objekt gjykimi, rrethanat e çështjes, pretendimet dhe prapësimet e palëve të parashtruara gjatë gjyimit në shkallën e parë, disponimin e shkallës së parë të gjyimit, por edhe arsytimin e hollësishëm të saj për mënyrën e zgjidhjes së çështjes.

### **Vlerësimi i aftësive profesionale të ndihmëses ligjore Aida Mërtiri, bazuar në rezultatet e testimit të zhvilluar në Shkollën e Magjistraturës**

37.10 Rezultoi se subjekti i rivlerësimit Aida Mërtiri ka përmbushur detyrimin e parashikuar nga neni 165, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, duke marrë pjesë në testimin e aftësive profesionale të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës enkas për ndihmësit ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë dhe gjykatave administrative të shkallës së parë dhe ato të Gjykatës Administrative të Apelit.

37.11 Kështu, Shkolla e Magjistraturës, me vendimin nr. 17, datë 21.5.2018, ka miratuar rezultatet e testimit profesional të subjekteve *ex officio* të shpallura nga Komisioni i Mbikëqyrjes së Vlerësimit Elektronik (faza e parë) dhe Komisioni i Vlerësimit të Testit (faza e dytë), sipas listave bashkëngjitur këtij vendimi. Nga përmbajtja e të dhënave të evidentuara në tabelën me pikët përfundimtare të fazës së dytë, pjesë përbërëse e vendimit nr. 17, datë 21.5.2018, rezultoi se ndihmësja ligjore Aida Mërtiri mori në total 113 pikë nga 200 pikë që ishte maksimumi i parashikuar në tabelë.

## **2. Aftësitë organizative**

### *Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë*

37.12 Subjekti i rivlerësimit Aida Mërtiri rezulton se ka ushtruar detyrën e ndihmësit ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë nga data e emërimit të saj 5.6.2015 e në vazhdim.

37.13 Në funksionin e ndihmësit ligjor pranë kësaj gjykate, ajo ka deklaruar se në periudhën 10.6.2015 – 8.10.2016 ka përpiluar 630 draft-relacione. Këto të dhëna statistikore janë pasqyruar nga vetë subjekti i rivlerësimit në formularin e vetëvlerësimit profesional.

37.14 Nga të dhënat statistikore të deklaruara nga vetë ndihmësja ligjore Aida Mërtiri, por edhe ato të dhëna të përcjella nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë për efekt të shortit, mund të themi se subjekti i rivlerësimit ka përfunduar në kohë detyrat e ngarkuara nga gjyqtari, të cilin ka asistuar.

### **3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale**

#### *a) Etika në punë*

37.15 Nga të dhënat e dërguara nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë me shkresën nr. \*\* prot., datë 20.1.2023, nuk rezultojnë të dhëna negative për etikën në punë të znj. Aida Mërtiri, për periudhën gjatë së cilës ajo ka ushtruar detyrën e ndihmësit ligjor pranë asaj gjykate. Gjithashtu, nga përmbajtja e shkresës së sipërcituar rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë objekt i ndonjë procedimi disiplinor për ndonjë shkelje të kryer prej saj.

#### *b) Integriteti*

37.16 Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Aida Mërtiri, nga informacioni i dërguar nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, por edhe nga dokumentet e vëzhguara, konstatohet se nuk ka të dhëna negative në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

#### *c) Paanësia*

37.17 Ndihmësi ligjor nuk ka kontakte me palët ndërgjyqëse, pasi nuk është pjesëmarrës në një proces gjyqësor dhe as subjekt procedural. Ndihmësi ligjor nuk është organ vendimmarrës, por këshillues, asistues i gjyqtarit. Në tërësi relacionet e përgatitura nga ndihmësja ligjore Aida Mërtiri nuk konstatohen elemente favorizuese apo njëanshmërie në raport me palët ndërgjyqëse pjesëmarrëse në ato procese gjyqësore që u korrespondojnë atyre relacioneve.

### **4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional**

#### *a) Aftësitë e komunikimit*

37.18 Në aktet ligjore të vëzhguara nuk ka të dhëna për mënyrën e komunikimit të subjektit të rivlerësimit Aida Mërtiri me palët ndërgjyqëse, pasi për shkak të natyrës së punës nuk ka kontakt me ta, ndërsa gjuha e përdorur në aktet e përpiluara prej saj mund të vlerësohet si korrekte dhe normale.

37.19 Në lidhje me aftësitë e ndihmësit ligjor Aida Mërtiri në komunikim me gjyqtarët e Gjykatës Administrative të Apelit, drejtuesin e gjykatës apo edhe me pjesëtarë të stafit administrativ të asaj gjykate nuk janë evidentuar probleme.

#### *b) Aftësia për të bashkëpunuar*

37.20 Nga aktet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit për të bashkëpunuar me gjyqtarët, me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Ndërkohë, në asnjë prej relacioneve të vëzhguara dhe praktikave përkatëse të trajtuara gjatë këtij procesi rivlerësimi nuk është evidentuar ndonjë problematikë në bashkëveprimin e saj me gjyqtarët që ka asistuar.



*c) Gatishmëria për t'u angazhuar*

37.21 Referuar dokumentacionit të dosjes rezultoi se znj. Aida Mërtiri, pas diplomimit si juriste, në periudhën 26.4.2010 – 10.6.2015 ka kryer detyrën e sekretares gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

37.22 Subjekti i rivlerësimit Aida Mërtiri në datën 5.6.2015 është emëruar si ndihmëse ligjore në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

37.23 Subjekti i rivlerësimit Aida Mërtiri në formularin e vetëdeklarimit ka deklaruar se ka kryer dy trajnimet në Shkollën e Magjistraturës në tre vitet e fundit të ushtrimit të detyrës.

### **38. Denoncime**

38.1 Nga verifikimi i kryer nuk rezultojnë denoncime të regjistruara për subjektin e rivlerësimit Aida Mërtiri.

#### **Konkluzion lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale**

**39.** Nga hetimi i thellë administrativ i kryer nga Komisioni nuk u provua asnjë *indicie* apo element që cenon kriterin profesional të ndihmësës ligjore Aida Mërtiri dhe, sipas parashikimeve të nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, është efektive dhe efiçente në masë të pranueshme dhe, përfundimisht, u vlerësua për kriterin profesional ‘*e aftë*’.

### **KONKLUZION PËRFUNDIMTAR**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, si dhe pasi dëgjoi subjektin në seancën dëgjimore publike, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Aida Mërtiri ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 58, si dhe të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Aida Mërtiri, ndihmëse ligjore pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.
2. Ky vendim, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesit ndërkombëtar, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më 31.5.2024.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Olsi KOMICI**  
**Kryesues**

**Suela ZHEGU**  
**Relatore**

**Brunilda BEKTESHI**  
**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Etmonda Hoxha*